


Statistika të Diplomimeve

2020-2021

Tiranë, më 13 Maj 2022: Në vitin shkollor 2020-21, u diplomuan në arsimin zyrtar 96.005 nxënës dhe studentë, me një ulje prej 2,2 %, krahasuar me vitin shkollor 2019-20. Ulje në numrin e të diplomuarve kanë patur të gjithë nivelet arsimore, 9 vjeçar, i mesëm dhe i lartë.

Sipas niveleve arsimore, struktura e diplomimeve në arsimin zyrtar është pothuajse e njëjtë, gjatë tre viteve të fundit shkollor/akademik.


Fig.1 Struktura e nxënësve dhe studentëve të diplomuar në arsim sipas niveleve arsimore, 2020-21 (%)



Arsimi Parauniversitar


Në vitin shkollor 2020-21, në arsimin 9-vjeçar u diplomuan 32.179 nxënës, duke shënuar një ulje prej 4,3 %, krahasuar me vitin e kaluar shkollor. Nga të diplomuarit në këtë nivel arsimor 52,9 % ishin djem dhe 47,1 % vajza.

Fig. 2 Nxënës të diplomuar në arsimin 9 vjeçar sipas gjinisë



Në arsimin e mesëm u diplomuan 31.136 nxënës, duke shënuar një ulje prej 1,7 %, krahasuar me vitin e kaluar shkollor. Në këtë nivel arsimor u diplomuan 47,3 % djem dhe 52,7 % vajza. Në arsimin profesional u diplomuan 3.831 nxënës. Të diplomuarit e arsimit profesional përbëjnë 12,3 % të të diplomuarve gjithsej në arsimin e mesëm. Raporti bruto i diplomimit në arsimin e mesëm per vitin shkollor 2020-21 është 79,6 %.

Fig. 3 Raporti bruto i diplomimit në arsimin e mesëm




Arsimi i Lartë

Në vitin akademik 2020-21, u diplomuan në arsimin e lartë 32.690 studentë, duke shënuar një ulje të lehtë prej 0,6 %, krahasuar me 2019-20. Studentët e diplomuar në programet Bachelor përbëjnë 54,0 % të studentëve të diplomuar gjithsej, ndjekur nga programet Master me 40,8 %.

Në të gjithë programet e arsimit të lartë, në këtë vit akademik, u diplomuan 21.592 studente femra, ose 66,1 % e numrit të përgjithshëm të studentëve të diplomuar në arsimin e lartë.


Fig. 4 Të diplomuar në arsimin e lartë sipas programeve të studimit dhe gjinisë, 2020-21



Fusha në të cilën janë diplomuar më shumë studentë në të gjitha programet është “Biznes, administrim dhe ligj” prej 30,0 % ose më shumë se një e katërta e numrit të përgjithshëm të të diplomuarve. Fusha e dytë më e preferuar nga meshkujt është “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim” me 18,9 % të të diplomuarve meshkuj. Ndërsa, nga femrat gjithsej të diplomuara, fusha e dytë e preferuar është “Shëndet dhe mirëqenie” me 18,3 % të të diplomuarave.

Analizuar për secilën fushë veças, fushat në të cilat janë diplomuar më shumë femrat krahasimisht me meshkujt janë “Arsim” (82,3 %), ndjekur nga “Arte dhe shkencë humane” (79,9 %) dhe “Shkencë sociale, gazetari dhe informacion” (79,1 %). Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë meshkujt krahasimisht me femrat janë “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim” (64,4 %), “Shërbime” (63,9 %) dhe “Teknologjia e informacionit dhe komunikimit” (61,6 %).

Fig. 5 Të diplomuar në arsimin e lartë sipas fushës së studimit dhe gjinisë, 2020-21



Aneks

Tab.1 Nxënës të diplomuar në arsimin parauniversitar

ISCED-2011	Niveli arsimor	2018-19			2019-20			2020-21		
		Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
1+2	Në arsimin 9 vjeçar	16.569	18.413	34.982	16.052	17.566	33.618	15.172	17.007	32.179
3	Në arsimin e mesëm	17.712	16.309	34.021	15.481	16.181	31.662	16.420	14.716	31.136
	<i>Gjimnaz dhe Social-Kulturor</i>	17.069	13.145	30.214	14.642	12.158	26.800	15.680	11.625	27.305
	<i>Profesional</i>	643	3.164	3.807	839	4.023	4.862	740	3.091	3.831

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tab. 2 Studentë të diplomuar në arsimin universitar

ISCED-2011	Niveli arsimor	2018-19			2019-20			2020-21		
		Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
5	Programe 2 vjeçare	133	352	485	404	669	1.073	597	725	1.322
6	Bachelor	12.280	6.416	18.696	11.556	6.029	17.585	11.660	5.990	17.650
7	Master	10.632	4.849	15.481	9.329	4.608	13.937	9.074	4.251	13.325
8	Doktoraturë	132	97	229	192	102	294	261	132	393
	Gjithsej	23.177	11.714	34.891	21.481	11.408	32.889	21.592	11.098	32.690

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit

Tab. 3 Studentë të diplomuar në arsimin universitar sipas fushave të studimit

Fusha e studimit	2018-19			2019-20			2020-21		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Shkenca arsimit	3.029	694	3.723	2.697	556	3.253	2.686	578	3.264
Arte dhe shkenca humane	2.930	816	3.746	2.783	795	3.578	2.522	635	3.157
Shkenca sociale, gazetari dhe informacion	2.758	909	3.667	2.623	779	3.402	2.388	631	3.019
Biznes, administrim dhe ligj	6.271	3.424	9.695	6.109	3.338	9.447	6.525	3.291	9.816
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	1.085	343	1.428	933	319	1.252	738	231	969
Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit	852	1.013	1.865	731	1.056	1.787	703	1.127	1.830
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	1.225	2.049	3.274	1.292	2.283	3.575	1.160	2.102	3.262
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar	503	617	1.120	487	593	1.080	543	676	1.219
Shëndet dhe mirëqenie	4.242	1.142	5.384	3.509	1.047	4.556	3.948	1.155	5.103
Shërbime	282	707	989	317	642	959	379	672	1.051
Gjithsej	23.177	11.714	34.891	21.481	11.408	32.889	21.592	11.098	32.690

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit

Metodologjia

Arsimi në Shqipëri është i organizuar sipas këtyre programeve dhe klasifikuar sipas Klasifikimit ISCED-2011 që përdoret ndërkombëtarisht në statistikat e arsimit:

Niveli 0 - Arsimi parashkollor – çerdhe/kopshte

Niveli 1 - Arsimi fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë

Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë

Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë – Gjimnaz / Profesional / Social kulturor

Niveli 4 - Arsimi pas të mesmes, jo i lartë

Niveli 5 - Arsimi i lartë, cikël i shkurtër

Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent

Niveli 7 - Master ose ekuivalent

Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

Përkufizime:

Arsimi parauniversitar përfshin arsimin që kryhet nga institucionet arsimore si kopshte, shkolla 9 vjeçare dhe të mesme.

Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë, përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor, i cili kryhet në klasat 1-5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët, i cili kryhet në klasat 6-9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi ka detyrimin të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.

Arsimi i mesëm përfshin gjimnazin, atë social–kulturor dhe arsimin profesional, cili ndahet në të ulët teknik dhe të lartë.

Arsimi profesional përfshin programet e arsimit të dizajnuara me qëllim përfitimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave specifike për një profesion të veçantë ose klasë të profesioneve.

I diplomuar në një program arsimor është një nxënës ose student, i cili ka përfunduar në mënyrë të suksesshme të gjitha kërkesat e programit.

Raporti bruto i diplomimit është numri i të diplomuarve pavarësisht moshës në një nivel arsimit në raport me popullsinë e moshës tipike që diplomohet në atë nivel specifik.

Burimi i të dhënave:

Të dhënat e statistikave të arsimit sigurohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me periudicitet vjetor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>